



Gjeja e pare qe duhet te dish ne lenden e punes dhe te sigurise ne pune eshte qe ne itali garantohen barazi trajtimi dhe barazi e plote e te drejtave te gjithë punonjesve te huaj me leje qendrimi te rregullt dhe po ashtu familjeve te tyre.

Pyet gjithmone kur fillon nje marredhenie te re pune kontraten e rregullt te punes. Puna e zeze dhe jo e rregullt demton ty dhe gjithë kolektivitetin. Nese punon pa rregulla je me i dobet dhe nuk mund te ushtrosh plotesisht te drejten mbi sigurine, mbi shendetin, pagesen e duhur dhe qendrimin tend ne itali.

Kjo broshure te ndihmon te kuptosh cfare do te thote te punosh ne kushte te sigurta.

Gjate punes ke nje detyre : te mos demtohesh.

Ka aktivitete me te rrezikshme se te tjerat e per kete kerkojne vemendje te madhe nga ana jote per te parandaluar demtimet ne pune dhe semundjet profesionale.

## **TE PARANDALOSH ESHTË ME MIRE SE TE RREZIKOSH !**

Per kete arsye duhet te kesh nje sjellje korrekte qe shpeton trupin dhe jeten tende !

Te tregojme se cilat jane qendrimet e sigurta per te mos u vrare ti dhe te tjeret kur jeni ne pune sepse shendeti yt eshte i cmuar jo vetem per ty por edhe per familjen tende.

Te tregojme edhe cilat jane te drejtat e tua si punonjes persa i perket sigurise ne vendin e punes.

Te informojme se cfare duhet te besh nese vritesh kur je duke punuar, kur te ndodh nje demtim, ose kur semuresh per shkak te punes.

Cdo vit , punonjesit e huaj, jane te prekur shpesh nga demtimet ne pune.

Pra eshte e rëndesishme te dish qe ligji te ndihmon te mbrosh shendetin tend kur punon.

Per kete arsye, punedhenesi yt ka detyra dhe pergjegjesi te vecanta ndaj teje.

Duhet ti njohesh ato : do te te duhen per te ditur cfare kerkon.

## **Siguria ne pune**

Cfare do te thote siguria ne pune ?

Do te thote te parandalosh e te zvogelosh rreziqet e demtimit ne pune e te semundjeve te shkaktuara ne pune.

Ne itali ka ligje qe parashikojne rregulla dhe sjellje per te shnderruar vendin e punes me te sigurte : cdo mundesi per te eliminuar nje rrezik duhet te lehtesohet e jo te pengohet.

Per kete arsye jane te domosdoshme edhe vemendja dhe bashkepunimi yt, pervec ndjenjes se pergjegjesise te punedhenesit tend dhe tuteles inail (instituti kombetar per sigurine kunder demtimeve ne pune).

## **Te drejtat dhe detyrat e tua**

Ti ke te drejte te :

- jesh i informuar nga punedhenesi yt ose nga pergjegjesi yt mbi rreziqet e aktivitetit tend dhe te ambientit te punes;
- te kerkosh kurse formimi punedhenesit tend per te njohur mire cilat jane keto rreziqe e si te zhvillosh ne siguri aktivitetin tend;
- te kesh instrumentet qe te mbrojne nga rreziqet qe nuk mund te eliminohen dhe eshte punedhenesi ai qe duhet te ti ofroje : jane dispozitivat e mbrojtjes individuale (DPI);
- te njohesh l'RSPP, ose pergjegjesin e sherbimit te parandalimit e te mbrojtjes, sherbim i formuar nga mjete dhe persona te caktuar per parandalimin dhe mbrojtjen nga rreziqet;
- te njohesh e ti drejtohesh RLS ose perfaqesuesit te punonjesve per sigurine, qe bashkepunon direkt me sherbimin e parandalimit;
- te njohesh emrat e te ngarkuarve per ndihmen e pare dhe te shpejte , per te ditur kujt ti drejtohesh ne rast nevoje.

- te dish kush eshte mjeku kompetent i caktuar, nder te tjera, per mbikqyrjen shendetsore te punonjesve, me kontrole periodike te gjendjes shendetsore.
- te njohesh procedurat e ndihmes se shpejte , te shuarjes se zjarrit e te evakuimit.

**Kujtohu te pyesesh kush eshte ne ndermarrjen tende pergjegjesi i sherbimit te parandalimit e te mbrojtjes rssp e perfaqesuesi i punonjesve per sigurine territoriale rlst te emruar nga organizatat sindakaliste ne territor.**

## **Detyrat e tua ndaj vetes dhe te tjereve**

Detyra jote e pare eshte te kujdesesh per veten : mos harro kurre rendesine e sigurise ne vendin e punes.

Mos u sill ne menyre qe shkakton rrezik : kjo ndihmon edhe shoket e tu te veprojne njesoj.

Puna naten e ve trupin ne lodhje dhe kerkon kujdes ne stilin e jeteses: mos nenvleftesoni sinjalet e lodhjes dhe kur nuk ndiheni mire.

Siguria jote eshte dhe siguria e te tjereve.

Te gjithë bashke mund te krijoni nje ambient pune me te sigurte.

Kujdes kur pini alkol e perdorni droga edhe te lehta, dobeshojne perceptimet e rrezikut per ty dhe koleget.

Normativa italiane ne kete drejtim eshte shume e ashper dhe parashikon gjoba te renda deri ne pushim nga puna.

## **Detyrat e tua**

Te perdoresh te gjitha dispozitivat e mbrojtjes individuale (DPI)

- pa i ndryshuar
- duke ndjekur instruksionet
- te kesh kujdes te perdoresh ne cdo rast ato te caktuarat per ty
- te besh stervitjen e detyruar per perdorimin korrekt te tyre

**Te sinjalizosh menjehere difektet e dpi**

**Te zbatosh instruksionet qe te jep punedhenesi mbi dpi e mbi sinjalet e rrezikut**

**Te japesh kontributin tend atij dhe te zgjedhurve per sigurine mbi zbatimin e drejte te rregullave te sigurise e te shendetit.**

**Te mos ndermarresh me iniciativen tende operacione apo manovra qe nuk jane kompetenca jote e qe mund te kompromentojne sigurine tende e te shoqeve te tjere ne pune.**

## PUNA SHTEPIAKE

Shtepia fsheh shume rreziqe si :

Shkallet, dyshemeja rreshqitese, sendet prerres(thika,gershere),korrenti,substanzat e rrezikshme(varechina),objekte dhe substanza te nxehta(hekuri per hekurosje,uji ose vaji i nxehte) , mikrobe qe mund te sjellin infeksione, kushte pune qe permbajne sforzim dhe qendrim trupi jo te rregullt.

Nese punon ne shtepi si sherbyese , pastruese, je nje normal punonjës i mvarur qe punon ne mvartesi te nje apo me teper punedhenesi e keshtu qe je i tuteluar ne rast zjarri shtepiak . Punedhenesi yt eshte i detyruar te derdhe cdo 3 muaj kontributet inps qe i transferon ne inail shumat kompetente.

Nese je nga 18 deri 65 vjec dhe ushtron aktivitetin tend shtepiak me raste, duke u kujdesur per personat e familjes tende e per ambientin ku jetoni, pa asnje kontrate e ne forme te lire e pa shperblim dhe nuk je duke bere aktivitete te tjera qe te detyrojne regjistrimin per parashikimin shoqeror, je i detyruar te besh sigurimin per tutelimin nga rreziqet e demtimeve per invaliditet te perhershëm qe shkaktohen nga puna "shtepiake". Jane te perfshira ne sigurimet edhe qytetaret e huaj qe jetojne me rregulla ne itali. Te gjitha informacionet mund te merren ne sportelet INAIL.

## Detyrimet e punedhenesit

**Per te te garantuar sigurine ne pune, punedhenesi yt duhet te parashikoje me perparesi :**

- Vleresimin e rreziqeve te lidhur me llojin e punes tende e qe nuk mund te evitohen, ne bashkepunim me rspp, mjekun kompetent e rls.
- te te informoje mbi rreziqet e aktivitetit tend e te ambientit rreth teje
- te beje te marresh pjese ne kurset e formimit per te njohur mire rreziqet e si te kryesh ajktivitetin tend ne siguri
- te te komunikoj kush eshte rspp, ose pergjegjesin e sherbimit te parandalimit e te mbrojtjes, sherbim i formuar nga mjete dhe persona te caktuar per parandalimin dhe mbrojtjen nga rreziqet;
- te te komunikoj kush eshte rls ose perfaqesuesi i punonjesve per sigurine, qe bashkepunon direkt me sherbimin e parandalimit;
- Te marre te gjitha masat qe sherbejne per parandalimin e demtimeve apo semundjeve per shkak te punes e te kontrolloje periodikisht mirembajtjen e tyre me ane te
  - furnizimit me te gjitha dpi qe ndryshojne sipas rrezikut : doreza, kepuce, rrip,syze,kufje kunder zhurmes,kasko,perparese,maskera, veshje fosforeshente e te tjera per te te mbrojtur kunder rreziqeve qe kercenojne shendetin tend dhe sigurine tende;
  - informacionet, formimit dhe stervitjes se pershtatshme te nevojshme per perdorimin e paisjeve qe duan njohje te vecante specialistike si kusht i pare per perdorim.
- te ekspozoj te gjitha sinjalet e sigurimit te nevojshem per te evituar rreziqet apo zvogeluar ato qe nuk mund te eliminohen
- te mbikqyre anen shendetsore te punonjesve ne respektin e normave te higjienes ne ambientin e punes., norma per tutelën e dhendetit te punonjesve.

Mund te verifikosh qe keto e masa te tjera te sigurimit te zbatohen ne menyre korrekte duke ju drejtuar rls apo rlst(perfaqesuesit te punonjesve per sigurine territoriale prane sindakatave).

## Cfare ndodh nese writeni demtim

### Infortunio

Nese demtoheni apo writeni kur punoni ose gjate rruges normale per pune ose ne kthim , (demtim si rrjedhoje), jane disa gjera qe duhet te besh patjeter edhe nese demi eshte i vogel :

- te lajmerosh sa me shpejt punedhenesin

- te shkosh menjehere ne ndihmen e shpejte ose tek mjeku yt e te deklarosh qe je vrare duke punuar e te tregosh ekzaktesisht si dhe ku ndodhi.

Mjeku ose ndihma e shpejte duhet te te leshojne nje certifikate ne disa kopje.

- nje nga keto kopje t'ia dorezosh sa me shpejt punedhenesit e nje mbaje ti. Nese do te te shtrojne, spitali i transferon punedhenesit dhe INAIL direkt certifikaten e vet.

Duhet te dish se keto deklarata jane te rendesishme per te patur nga inail te gjitha sherbimet qe te nevojiten edhe pse nuk ke nje kontrate pune te rregullt

Nese me skadencen e certifikates nu je ende i sheruar mund ti drejtohesh selise inail afer teje ose mjekut tend per te te leshuar nje certifikate te re.

Nese nuk mund te punosh per me teper se 3 dite, punedhenesi eshte i detyruar te paraqese denoncimin e demtimit dhe certifikaten mjekesore inail brenda 2 diteve nga data qe e ka marre ne dorezim.

Kontrollo qe ta kryeje se eshte edhe ne interesin tend e nese nuk e be beje ti vete.



## Semundja profesionale

Shume semundje mund te shkaktohen nga aktiviteti i punes. Edhe ne keto raste inail te tutelon. Nese ke probleme shendeti te lidhura me punen qe ben ose ke bere duhet ti drejtohesh mjekut te familjes qe duhet te verifikoje semundjen e te te leshoje nje certifikate.

Nese je duke bere te njejten pune per shkak te se ciles je semurur duhet te dergosh certifikaten e mjekut punedhenesit brenda 15 ditesh e nese kurat vazhdojne duhet te dergosh te gjitha certifikatat qe vijojne. Nese nuk e kryen me ate aktivitet mund te paraqitesh direkt ne INAIL kekesen e njohjes se semundjes profesionale.



## **Sherbimet**

Nese demtohesh ne pune ose semuresh per shkak te punes ke te drejte te nje sere sherbimesh ekonomike e shendetsore nga INAIL.

Tutelimi te takon edhe ne rast se punedhenesi nuk ka paguar sigurimet.

Sherbimet jane ekonomike dhe shendetsore. Jane mjaft te rendesishme sepse mund te kesh :

- nje shume ditore parash nese nuk sherohesh brenda 3 diteve( eshte nje sherbim ekonomik i quajtur shperblim per paaftesi te perkohshme absolute)
- kurat mjekesore falas nga sherbimi kombetar shendetsor prane ndihmes se shpejte ( sherbime shendetsore)
- kurat mjekesore te specializuara falas prane qendrave te specializuara te sherbimit kombetar shendetsor e prane qendrave mjekesore ligjore prane selive INAIL (sherbime shendetso-re)

Per te patur keto sherbime inail duhet te paraqesesh kerkesen brenda 3 vjetesh nga data qe ke komunikuar demtimin ose te manifestimit te semundjes profesionale.

Per praktikat mund te kerkosh asistence ne sindakatat qe tute-lojne te drejtat e tua falas.

## **Ne rast demtimi vdekjeprures**

Ne rastin kur punonjesi eshte viktime e nje aksidenti vdekjeprures parashikohen sherbime ekonomike per familjaret dhe nje cek per shpenzimet e varrimit.

Familja edhe nese jeton jashte italise do te mbeshtetet nga inail me nje te ardhur mujore. Per ta marre kete , familjaret duhet te paraqesin sa me shpejt kerkesen.

## **Kujt ti drejtoheni**

### **INAIL**

Mund te kontaktoni inail  
ne numrin gratis 803.164

- nga e hena deri te premten nga ora 8,00 deri ne oren 20,00
- te shtunen nga ora 8,00 deri ne oren 14,00
- sherbimi automatik eshte aktiv 24 ore ne dite edhe ne ditet e festave
- informacionet jepen edhe ne 7 gjuhe te huaja: gjermanisht, anglisht, frengjisht, arabisht, polonisht, spanjisht dhe rusisht.

Selia INAIL me e afert  
RAVENNA, rruga Farini , 54  
TEL 0544 548411

FAENZA  
rruga Mengolina, 10  
TEL 0546 637011

LUGO  
Sheshi Enzo Ferrari, 1  
TEL 0545 907611

Sportelet jane te hapur per publikun nga e hena deri te premten  
nga ore 8,30 deri ne oren 12,00  
Te henen edhe nga ora 14,30 deri ne oren 16,00  
Nese ke nevoje ti drejtohesh asistentes sociale mund te kerkosh  
nje takim ne sportelin "PUNONJESIT"

## **Organizatave sindacale**

**RLST: Perfaqesuesit e Punonjesve per Sigurine Territoriale prane  
Organizatave Sindakaliste**

### **CGIL**

**rruga P.Matteucci n°15 - 48121 Ra**

**Tel 0544/244246/211 mail info81cgilra@er.cgil.it**

### **CISL**

**rruga Vulcano n°78/80 - 48124 Ra**

**Tel 0544/261811 - mail salutesicurezza.ravenna@cisl.it**

### **UIL**

**rruga Le Corbusier n° 29 - 48124 Ra**

**Tel 0544/292011 - mail segreteria@uil-ravenna.it**

Per cdo dyshim ne lidhje me kontraten tende te punes mund ti drejtolesh sporteleve te organizatave sindakale me te aferta me ty: referentet sindakale mund te te ndihmojne te kuptosh te drejtat dhe detyrat e tua lidhur me kontraten e punes; dhe Patronatet Inca Cgil, Inas Cisl dhe Ital Uil, mund te te ndihmojne te besh praktiken per te marre shperblimet qe te takojne ne rast demtimi ne pune.

Ne rast se ti zgjidhesh si perfaqesues i punonjesve per sigurine ne ndermarjen tende mund te kerkosh mbeshtetje teknike dhe informative SIRS (Sherbimi Informativ per RLS) i lindur nga nje protokoll midis mjekesise se punes, Cgil-Cisl-Uil e provinca e Ravennes. Duke u lidhur me sitin:

[www.sirs.provincia.bologna.it/SIRS-RA/sirs-ra.htm](http://www.sirs.provincia.bologna.it/SIRS-RA/sirs-ra.htm)

## **Njesia shendetsore lokale**

**Sherbimi parandalimi dhe siguria ne ambientin e punes**

**Ravenna Via Fiume Abbandonato, 134;  
Hapur per publikun  
hene, merkure, pemte: 8.30-13.00  
martë, enjte: 8.30-13.00; 14.30-17.00  
Telefon 0544 286830; e-mail: ra.spsal@ausl.ra.it**

**Faenza Via Zaccagnini, 22  
Telefon 0546 602524; e-mail: fa.spsal@ausl.ra.it  
hapur per publikun  
hene, merkure, premte: 8.30-13.00  
martë, enjte: 8.30-13.00; 14.30-17.00**

**Lugo via Vittorio Veneto, 8 c/o Centro socio-sanitario  
Bagnacavallo  
Hapur per publikun  
hene, merkure, premte: 8.30-13.00  
martë, enjte: 8.30-13.00; 14.30-17.00, SHTUNE ,30-12,30  
Telefon 0545 283041; e-mail: lu.spsal@ausl.ra.it**

**Ndihma e Shpejte  
n. telefon per URGJENCEN: 118  
Ravenna Viale Randi, 5 - 48100 Ravenna  
Faenza Viale Stradone, 9 - 48018 Faenza  
Lugo Viale Masi – 48022 Lugo**

## Glossario

**Paisje pune:** cfaredolloj makinerie, aparature, vegle apo impianti , i nenkuptuar si teresia e makinerive, paisjeve e pjeseve perberese te nevojshme ne zhvillimin e nje aktiviteti ose ne zbatimin e nje procesi prodhues i destinuar per perdorim gjate punes.

**Ndermarrje:** teresia e strukturese se organizuar nga punedhenesi publik apo privat.

**Punedhenesi:** titullari i marredhenies se punes me punonjesin e gjithsesi ai qe mban pergjegjesine e organizimit prane se ciles punonjesi ushtron aktivitetin e tij. Ne administraten publike, per punedhenes nenkuptojme drejtuesin te cilit i takon pushteti zbatues.

**Familjare ne ngarkim:** konsiderohen familjare ne ngarkim nga ana fiskale bashkeshorti jo i ndare ligjerisht, femijet perfshire ata natyrore te njohur, te adoptuar, te besuar e te bashkangjitur; prinderit ( edhe te adoptuar); te prejardhurit e aferm edhe natyrore; bashkeshorti i ndare; dhenderri, nusja e krushq; vel-lezer e motra, vetem nese jetojne me personin kontribues ose nese perftojne nga ai nje cek per ushqime.

**Aksident (ne pune):** ngjarje qe ka shkaktuar deme objekteve e qe ka nderprere pjesisht ose teresisht aktivitetin e punes.

**Dentim ne pune:** ngjarje e tipit traumatik qe ka shkaktuar deme psiko-fizike nje punonjesi gjate zhvillimit te detyrave te tij ne pune ose ne aktivitetet qe kane si qellim zhvillimin e punes se tij. Raporti shkaku - pasoja ka efekt te menjehershem.

**Punonjes:** person qe, pavaresisht nga lloji i kontrates, zhvillon nje aktivitet prane nje punedhenesi publik apo privat. Jane punonjes: ortaku punonjes i nje kooperative apo shoqerie, ortaku pjesemarres, pjesemarresi ne aktivitete te stazhit formues apo orientues, pjesemarresi ne kurset e formimit dhe studenti uni-

versitar qe perdorin labororet, paisjet e punes, agjentet kimike, fizike e biologjike ose qe perdorin videoterminale, vullnetaret, edhe ne sherbim civil.

**Semundje profesionale:** patologji qe ka si shkak, nder te tjera, ushtrimin e nje aktiviteti pune dhe qe percaktohet nga ekspozimi i perzgjatur me nje agjent te demshem(organizues, kimik, fizik, etj ) . Mund te shfaqet edhe pas shume vitesh ekspozimi , e mund edhe te ndodhe qe semundja te shfaqet edhe pas shume vitesh se lenies se aktivitetit ( per nje aktivitet tjetet ose per perfundim te aktivitetit).

**Mjeku kompetent:** mjek i paisur me nje nga keta tituj: specializim ne mjekesine e punes, apo ne mjekesine parandaluese te punonjeseve e psikoteknike; docent ne lenden e mjekesise se punes ( mjekesia parandaluese e punonjesve, toksikologjia industriale, higjiena industriale, fiziologjia e higjiena e punes , klinika e punes); autorizim sipas normave te dlgs 15.08.1991, nr. 277; specializim ne higjiene e mjekesi parandaluese ose ne mjekesine legale.

**Perfaqesuesi i punonjesve per sigurine ne pune (RLS):** person i zgjedhur apo i caktuar per te perfaqesuar punonjesit persa i perket aspekteve te shendetit dhe te sigurise gjate punes.

**Pergjegjesi i sherbimit te parandalimit e mbrojtjes (RSPP):** person i paisur me nje diplome te shkolles se mesme apo me certifikate frekuentimi, me verifikim te mesimdhenies, ne kurse te vecanta formimi ne lenden e prevencionit e mbrojtjes nga rreziqet, te pershtatur me karakteristikat e vendit te punes dhe relative me aktivitetet e punes qe zhvillohen atje, e ne lende organizimi e drejtimi te aktivitetit teknik - administrativ e teknikave te komunikimit nbe ndermarrje apo marredheniet me sindikatat.

**Sherbimi i parandalimit e mbrojtjes nga rreziqet:** teresia e personave, sistemeve dhe menyrave te jashtme apo te brendhme te ndermarrjes qe kane si qellim sherbimin e parandalimit dhe te mbrojtjes nga rreziqet profesionale per punonjesit.

**Mbikqyrja shendetsore:** teresia e akteve mjekesore , qe ka si qel-  
lim mbrojtjen e shendetit dhe sigurine e punonjesve, ne lidhje  
me ambientin e punes, me faktoret rrezikues te profesionit dhe  
me menytrat e zbatimit te aktivitetit.

**Vleresimi i rreziqeve:** vleresim teresor e i dokumentuar i te gji-  
tha rreziqeve per shendetin dhe sigurine e punonjesve te prani-  
shem ne ambientin e punes, qe ka per qellim te dalloje masat e  
duhura per prevencion e mbrojtje e te veprojne per permiresim,  
ne kohe, nivelin e shendetit dhe te sigurise.

Rif. Ligjor: dlgs 81/2008; dlgs 106/2009; legge 122/2010 me  
ndryshime te dlgs 78/2010; direktivat e komunitetit europian  
38/2004.

